



(Albanian - Shqip)

Kthimi përsëri në shkollë – Udhëzime për prindër lidhur me Covid-19

Hyrje

- Shkollat do të rihapen së shpejti pas pandemisë Covid-19 dhe kjo do të jetë një përvojë e re dhe sfiduese për nxënësit, prindërit dhe stafin e shkollës.
- Është e rëndësishme të punojmë së bashku për t'u përgatitur sa më shumë që të jetë e mundur për një tranzicion të suksesshëm.
- Duhet të jemi të vetëdijshëm që përvoja do të jetë e ndryshme për të gjithë, por ka disa faktorë kyç që do t'ju ndihmojnë të gjithëve nëse i marrin në konsideratë gjatë përgatitjes për 'normalen e re'.

Shkollat nuk janë 'mbyllur'

- Shumica e mësuesve dhe personeli ndihmës kanë vazhduar të punojnë ose në qendrat shkollore ose kanë ofruar mësim në distancë nga shtëpia
- Personeli ka vazhduar të punojë në mënyrë kreative për të mbështetur mësimin dhe mirëqenien dhe është kërkuar nga ata të punojnë me orar më të gjatë, përfshirë edhe gjatë pushimeve.

Të gjitha shkollat janë të ndryshme – por të gjithë jemi duke punuar së bashku!

- Shkollat janë të gjitha të ndryshme dhe kanë sfida dhe kërkesa të ndryshme për të menaxhuar gjatë rihapjes për nxënësit. Prioriteti kryesor do të jetë siguria dhe mirëqenia e të gjithë përdoruesve.
- Si rezultat i çështjeve të ndryshme lokale, numrit të punonjësve të aftë për ty kthyer në punë dhe aftësisë fizike të shkollës, shkollat mund të mos jenë në gjendje të ofrojnë shërbimet që mund të kenë ofruar më parë – të tilla si klubet e mëngjesit/klubet pas shkollës etj. Shkolla juaj do t'ju njoftojë se çfarë do të jenë në gjendje të ofrojnë.
- Në mënyrë që të mbajnë të gjithë të sigurt, shkollat duhet të kufizojnë numrin e vizitorëve. Kjo mund të nënkuptojë që prindërit nuk do të jenë në gjendje të hyjnë në shkollë në të njëjtën mënyrë si para pandemisë Covid-19. Poashtu, do të thotë se do të ketë sisteme të ndryshme për mënyrën se si fëmijët hyjnë dhe dalin nga shkolla. Këto janë dizajnuar për të mbajtur të gjithë të sigurt.

Dita në shkollë

Dita në shkollë do të duket ndryshe nga mënyra se si e kemi përjetuar më parë:

- Koha e fillimit dhe e mbarimit mund të ndryshojnë. Shkolla juaj do t'ju informojë lidhur me këtë menjëherë sapo të kenë përfunduar planifikimin.
- Grupimet e fëmijëve do të jenë të ndryshme dhe fëmijët mund t'i mësojnë punonjës të tjerë nga ata që kanë punuar më parë me ta. Shkollat do të jenë në gjendje të ndajnë këtë informacion sapo të mësojnë se kush nga punonjësit dhe nxënësit do të kthehen në shkollë.
- Fëmija juaj mund të ndjekë mësimet në një pjesë tjetër të shkollës.
- Koha e drekës dhe pushimit do të jetë e ndryshme pasi do të na duhet të respektojmë distancën sociale.
- Fëmijët nuk do të mbledhen në grupe të mëdha.

Përgatitja për 'Normalen e re'

- Do të ketë emocione të përziera rreth kthimit në shkollë. Njerëzit mund të kenë pritshmëri se kjo do të thotë kthim në mënyrën sesi gjërat ishin më parë, por duhet të pranojmë që kjo nuk do të ndodhë.
- Mendimet, ndjenjat dhe sjellja e njerëzve mund të kenë ndryshuar nga përvojat e tyre gjatë pandemisë Covid-19. Rutinat, strukturat, mjediset e të mësuarit dhe pritjet mund të jenë të ndryshme.
- Duhet të jemi të kujdesemi për veten dhe të sjellshëm me të tjerët: dhënia e prioritetit mirëqenies emocionale është thelbësore në përshtatjen e suksesshme me 'normalen e re'.

Mbështetja për nxënësit

- Personeli i shkollës tashmë ka aftësi dhe ekspertizë në ofrimin e mbështetjes gjatë tranzicioneve. Ne mund të ndërtojmë mbi këtë njohuri për të mirëpritur komunitetin e shkollës dhe t'i mbështesim nxënësit që të kthehen në shkollë pas kësaj periudhe kohore të paparë deri më tani.

Rivendosja e rutinës dhe pritshmërive

- Do të duhet të lejojmë një periudhë përshtatjeje dhe të jemi të ndjeshëm ndaj dallimeve dhe përvojave individuale.
- Të fituarit e ndjenjës për rutinë dhe strukturë siguron parashikueshmëri dhe ndjenjën e sigurisë për fëmijët si dhe të rriturit. Shkollat do të përqipen të zhvillojnë rutina dhe struktura të reja për të siguruar ndjenjën e stabilitetit për të gjithë. Çdo shkollë do t'ia komunikojë këto personelit, prindërve dhe nxënësve përmes kanaleve zakonshme të komunikimit.

Dallimet në përvojat e nxënies

- Falenderojmë të gjithë prindërit për mbështetjen dhënë fëmijëve të tyre gjatë kësaj periudhe sfiduese!
- Fëmijët duhet të kenë pasur përvoja të ndryshme gjatë mësimit në shtëpi gjatë periudhës së izolimit.
- Të mësuarit në shtëpi nuk është i njëjtë me të mësuarit në shkollë. Shkollat do të duhet t'u përgjigjen përvojave të ndryshme që kanë pasur fëmijët dhe të vlerësojnë ato që fëmijët *kanë* mësuar, duke i mbështetur ata me ato që mund të kenë harruar.

Përvojat në nxënie pas kthimit në shkollë

- Shkollat do të duhet të përqëndrohen në rivendosjen e marrëdhënieve dhe uljen e ankthit lidhur me kthimin në shkollë. Pikë fillestare mund të jetë eksplorimi i aftësive dhe cilësive personale që fëmijët kanë zhvilluar sa kanë qenë jashtë shkollës.
- Sa i përket nxënësve të vitit 10 dhe 12, përpos asaj që u tha më sipër, personeli do të përqëndrohet në përgatitjen e nxënësve për provimet që duhet të kalojnë në të ardhmen.

Mësimi i përzier do të jetë "normalja e re" për ca kohë

- Të mësuarit e përzier është një qasje ndaj të mësuarit që ndërthurë përvojat e mësimit në klasë dhe në internet. Seancat online dhe offline do të plotësojnë njëra-tjetrën duke përdorur pikat më të forta të secilës.
- Udhëzimet e Këshillit të Swansea për zhvillimin e një qasjeje të fuqishme të të mësuarit të përzier është krijuar për të ndihmuar personelin të rrisë maksimalisht përvetësimin e njohurive, aftësive dhe përvojave të rëndësishme nga nxënësit gjatë izolimit.

Marrëdhëniet ndërnjerëzore

Ne duhet të mendojmë për mënyrat e rivendosjes së marrëdhënieve:

- Midis mësuesve dhe nxënësve
- Midis shkollave dhe prindërve
- Midis nxënësve dhe miqve të tyre dhe grupit më të gjërë të bashkëmoshatarëve
- Dhe midis kolegëve

Kjo nuk do të ndodhë brenda natës dhe ne duhet t'i japim vetes kohë dhe duhet të jemi të ndjeshëm ndaj vetes dhe me njëri-tjetrin.

Fëmijët e punonjësve kyç

- Ka mundësi që fëmijët e 'punëtorëve kyç' janë duke përjetuar nivel të rritur të ankthit. Ata mund të kenë shqetësime se anëtarët e familjes së tyre po rrezikojnë duke shkuar në punë. Jeta normale në familje dhe rutinat mund të jenë ndërprerë për disa fëmijë.
- Shkollat janë të vetëdijshme për këto shqetësime dhe ankthin dhe do të punojnë me prindërit për të siguruar që fëmijët përkrahen siç duhet.

Mbajtja e të gjithëve të sigurt

- Të gjitha shkollat kanë përpiluar vlerësime të qarta për rrezikun, rregullat dhe rutinat për të mbështetur shëndetin dhe sigurinë e të gjithë përdoruesve pas kthimit në shkollë. Këto do të përfshijnë:
 - Masat për distancim social
 - Larja e duarve dhe rutinat për pastrim
 - Pastrimi i rregullt i zonave me prekje të shpeshtë
 - Etika gjatë kollitjes dhe teshtitjes
 - Pritjet e qarta të sjelljes ndaj të tjerëve
 - Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale (PPE) në rastet e pershtatshme
- Këto rutina do të duhet të respektohen në mënyrë rigoroze nga të gjithë përdoruesit e shkollës për të siguruar një mjedis pune të sigurt për të gjithë.

Mjedisi shkollor

- Fëmijët nuk do të jenë në gjendje të ulen pranë të tjerëve. Tavolinat dhe karriget do të jenë 2m larg njëra-tjetrës. Disa nga mobiljet në shkollë janë largur për të krijuar hapësirën e duhur që nxënësit të ulen 2m larg njëri-tjetrit.
- Nëpër shkolla mund të vendosen sisteme një-kahëshe që t'u mundësohet fëmijëve dhe personelit të mbajnë distanca të sigurta në korridore dhe gjatë lëvizjes nëpër shkollë. Fëmijët mund të kufizohen në pjesë të caktuara të shkollës.
- Fëmijët nuk do të jenë në gjendje të përdorin burime siç kanë bërë më parë dhe disa gjëra do të hiqen pasi do të na duhet të sigurohemi që gjithçka është e pastër.
- Fëmijëve do t'u kërkohet të lajnë duart rregullisht.
- Prindërit nuk do të kenë qasjen e njëjtë në shkollë si më parë për të na ndihmuar të mbajmë mjedisin sa më të sigurt.

Mbajtja e të gjithëve të shëndetshëm

- Është jashtëzakonisht e rëndësishme të mbahet kontakt minimal me individë që nuk ndihen mirë me shëndet duke siguruar që ata që kanë simptoma të koronavirusit

(COVID-19), ose që kanë dikë në familjen e tyre që shfaqin këso simptoma, nuk do të paraqiten në mjediset e shkollës nën asnjë rrethanë.

- Fëmijët dhe punonjësit që shfaqin simptoma nuk duhet të vijnë në shkollë.
- Fëmijët dhe personeli që kanë qenë në kontakt me dikë që ka koronavirus duhet të vetëizolohen sipas këshillave të qeverisë dhe nuk duhet të vijnë në shkollë.
- Çdo fëmijë ose punonjës që tregon shenja të simptomave të koronavirusit gjatë kohës sa është në shkollë do të izolohet dhe do t'i kërkohet të shkojë menjëherë në shtëpi. Do të bëhet pastrim i thellë i zonave që mund të jenë prekur dhe do të fillojë gjurmimi i kontakteve.

Personeli dhe fëmijët që janë duke u mbrojtur

- Nëse një nxënës merr letër që i këshillon ata se duhet të mbrohen, atëherë ai/ajo nuk duhet të vijë në shkollë
- Nëse një nxënës jeton me një anëtar të familjes i cili ka marrë letër që i këshillon ata se duhet të mbrohen, atëherë nxënësi nuk është i detyruar të vijë në shkollë
- Qeveria Uellsiane ka sqaruar se familjet që nuk dërgojnë fëmijët e tyre në shkollë nuk do të gjobiten.

Përballja me humbjen e ndonjë të afërmi

- Për fëmijët që kanë humbur ndonjë të afërm, është e rëndësishme që atyre t'u ofrohet mbështetje për të kuptuar se çfarë ka ndodhur dhe të kenë mundësi për të folur.
- Njësoj si të rriturit, edhe fëmijët reagojnë ndaj humbjes së të afërmeve në mënyra të ndryshme, veçanërisht gjatë kësaj kohe kur mund të mos kenë pasur mundësi t'i thonë të afërmit lamtumirë.
- Personeli kyç në shkollë ka ndërmarrë trajnime të mëtutjeshme për t'u mundësuar atyre të mbështesin fëmijët të cilët mund të kenë humbur ndonjë të afërm.

Ankthi social

- Disa fëmijë i gëzohen kthimit në shkollë, por do të ndjehen të frikësuar dhe të hutuar nga disa aspekte të të qenit rreth të tjerëve.
- Distanca sociale do të ketë shkaktuar rritje të ndjenjës së ankthit për disa fëmijë dhe të rritur gjatë komunikimit të tyre me të tjerët.
- Për ca kohë, përvoja jonë me njerëz të tjerë mund të ketë qenë e kufizuar në familjen e afërt.
- Personeli do të jetë i ndjeshëm ndaj kësaj dhe do të sigurojë mbështetje aty ku është e nevojshme.

Ankthi i ndarjes

- Shumica e fëmijëve janë mësuar të kalojnë periudha të gjata kohore me prindërit /kujdestarët dhe familjen e tyre të ngushtë gjatë izolimit.
- Megjithëse shumë fëmijë do të jenë të etur për të rifituar lirinë e tyre dhe të shohin miqtë e tyre, kjo gjithashtu mund të jetë një burim i mundshëm i ankthit për ta.
- Fëmijët mund të kenë vështirësi kur të ndahen fillimisht nga prindërit e tyre dhe mund të ndiejnë ankth për ca kohë. Kjo ndarje mund të jetë veçanërisht e vështirë për fëmijët e punëtorëve kyç.
- Personeli i shkollës do të jetë i vetëdijshëm për këtë ankth dhe do t'i mbështesë nxënësit me ndjeshmëri në menaxhimin e shqetësimeve të tyre

Nevoja për mësim shtesë

- Fëmijët me nevojë për mësim shtesë mund të jenë ndikuar më shumë nga rrethanat e reja si rezultat i COVID-19.
- Aftësia për të menaxhuar përgjigjet emocionale në lidhje me një situatë të re dhe të ndryshme gjithashtu mund të ketë qenë më e vështirë.
- Shkollat do të luajnë rol mbështetës për t'u mundësuar të gjithë nxënësve dhe personelit të menaxhojnë ndryshimet që do të përjetojnë gjatë kthimit në shkollë.
- Shkollat do të vazhdojnë të punojnë me profesionistë dhe agjenci të tjera të tilla si psikologë të arsimit, mësues të specializuar për përkrahje në sjellje etj. për të mbështetur nevojat e nxënësve me nevoja për mësim shtesë.

Nxitja e përvojave ndijore

- Për disa, kthimi në shkollë mund të shkaktojë vështirësi më të mëdha në aspektin ndijor.
- Kjo mund të jetë veçanërisht problematike për disa fëmijë përfshirë ata me nevoja për mësim shtesë.
- Shkollat do të jenë vigjilente për këtë dhe do të punojnë për të gjetur mënyra për të krijuar hapësira të qeta dhe aktivitete për të gjithë.

Tranzicionet

- Shkollat dhe kolegjet do të punojnë së bashku për të siguruar që çdo tranzicion të menaxhohet sa më mirë që të jetë e mundur për të mbështetur nxënësit gjatë këtyre momenteve kyçe në arsimimin e tyre.
- Nxënësit që fillojnë një mjedis ose fazë të re në arsim do të kenë nevojë për një tranzicion të planifikuar. Shkollat dhe kolegjet do të punojnë së bashku për të bërë të mundur që fëmijët të mësohen si në mjedisin e ri, ashtu edhe me përvojën e kthimit në arsim. Mos harroni - disa shkolla tashmë mund të kenë ndërmarrë shumë nga aktivitetet e tyre të tranzicionit.
- Shkolla e fëmijës tuaj do të vë në dispozicion udhëzime të mëtejshme për këtë pas njoftimeve të qeverisë Uellsiane.

Mbështetja për personelin

- Personeli i shkollës ka pasur përvoja të ndryshme gjatë izolimit që mund të ndikojnë në qëndrueshmërinë e tyre kur kthehen në shkollë. Ata mund të kenë pasur ndonjë rast vdekjeje në familje/shoqëri, ose punuar pa pushim nën nivel të lartë stresi, ose ndoshta nuk kanë punuar për shkaqe shëndetësore.
- Është thelbësore që komuniteti shkollor të marrë parasysh përvojat e ndryshme individuale kur të shqyrtojë se si të mbështesë stafin. Ofrimi i kohës së mjaftueshme për rindërtimin dhe reformimin e komunitetit të shkollës do të jetë thelbësore për suksesin e tij.
- Guvernatorët dhe shërbimet mbështetëse të Autoritetit Lokal kanë rolin e ofrimit të mbështetjes për drejtorët dhe ekipet e zyrtarëve të lartë të menaxhimit, se si të kujdesen për veten dhe si të mbështesin personelin, nxënësit dhe prindërit gjatë kthimit në shkollë.

Rimëkëmbja

- Disa njerëz do të preken më shumë nga ndikimi i Covid-19 sesa të tjerët.
- Rimëkëmbja duhet të mbështetet nga parimet e kujdesit.
- Duke klikuar në të djathtë mund të fitoni qasje në një burim të dobishëm për zbatimin e parimeve të kujdesit pas izolimit.

Mos harroni... Rri i/e qetë - ne jemi të gjithë në këtë së bashku...

Linqe të tjera

[Swansea virtual school](#) / Shkolla virtuale e Swansea

[FAQ page](#) / Pyetje të zakonshme

[Exchange](#) / Shkëmbim

[Cruse bereavement](#)

[Swansea council coronavirus page](#) / Faqja e Këshillit të Swansea mbi koronavirusin

[Swansea council learning page](#) / Faqja e Këshillit të Swansea për mësim

Nëse dëshironi të flisni me dikë në një gjuhë tjetër nga anglishtja/gjuha uellsiane, ju lutemi dërgoni email në EMAU@swansea.gov.uk me numrin tuaj të telefonit dhe gjuhën që preferoni dhe dikush do t'ju telefonojë.